

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E HËNË 31 TETOR 2022

Zonja drejtuese e seancës,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Të dashur qytetarë dhe qytetare që ndiqni punimet e këtij parlamenti të shndërruar nga kjo pseudomazhorancë në një klub, në të cilin merren vendime dhe miratohen ligje në kurriz tuajin, të fëmijëve tuaj dhe familjeve tuaja. Sot kjo pseudomazhorancë, e bazuar e tëra në drogën, krimin dhe vjedhjen, është pas pseudomazhorancës së Lukashenkos, më e damkosura në Europë dhe ndër më të damkosurat në botë. Sot kjo pseudomazhorancë, pas dhunimit të votës së lirë, ka rrokullisur Shqipërinë në vendin me indeksin e shtetit ligjor 4 shkallë nën Vietnamin socialist. Vietnami, apo Republika Socialiste e Vietnamit, është një shtet në kushtetutën e të cilit sanksionohet Partia Komuniste e Vietnamit si forcë udhëheqëse politike e vendit. Është një shtet që ka adoptuar modelin e tregut të Ten Siao Pinit, pra, një diktaturë, që pranon për interesat e saj, ekonominë e tregut.

Republika e Shqipërisë është një diktaturë, e cila, pavarësisht lidhjeve të grupit drejtues me të shkuarën, nuk mund të them se bazohet në ideologjinë Marksiste-Leliniste, por është një narkodiktaturë, që bazohet në krimin, drogën dhe vjedhjen e qytetarëve. Me të drejtë qytetarët mund të pyesin: si ka mundësi që një vend komunist me kushtetutë moniste dhe kushtetutë parti-shtet të jetë më mirë në zbatimin e ligjit sesa një vend anëtar i Këshillit të Europës dhe i NATO-s, që ka hapur negociatat dhe që në Kushtetutë ka ndarjen e pushteteve dhe shtetin ligjor?! Të gjitha këto vijnë, sepse në këtë vend vota është fiktive, njësoj si në Vietnamin komunist; të gjitha këto vijnë, sepse në këtë vend vendimet në qeveri, në parlament, në bashki, prokurori, gjykata, polici e kudo i merr krimi, droga, rryfsheti dhe vjedhja. Kjo është e vërteta. Për Edi Ramën nuk ka ligje dhe nuk ka Kushtetutë që të pengojë vjedhjet e tmerrshme të tij, si dhe nuk ka standard moral që t'i diktojë atij të mbajë një kod.

A e dini, të dashur qytetarë, se ai njeri, ka udhëtuar 137 herë me çarter?! Një çmenduri të tillë abuzive nuk ia ka lejuar vetes asnjë diktator, asnjë korruptor tjetër përveç këtij. 22 milionë euro ka shpenzuar kryeministri i vendit më të varfër të Europës, dy herë udhëtime më shumë në çarter sesa presidenti i vendit më të pasur të botës. Çfarë është kjo?!

Qytetarë,

Këta kanë urrejtje për ju, nuk mendojnë për ju, por ju shohin si qenie inferiore për t'ju shtypur dhe mashtruar. Këta, dadot e koneve i paguajnë me rroga 2-3 herë më të larta sesa merrni ju, kujdestarin e breshkave e paguan me një çmim 3 herë më të madh se një rrogë e mesme. Kurrë nuk pa pasur Shqipëria qeveritarë të tillë korruptivë si këta. Etërit e tyre ishin mizorë dhe gjakësorë, por ju garantoj se të gjithë së bashku, me në krye Enver Hoxhës, të marra në 20 vjet, nuk kanë shpenzuar në tërësi sa ka shpenzuar Edi Rama, 22 milionë euro, për udhëtime. A mendoni ju se ka fëmijë të sëmurë në këtë vend, që nuk gjejnë ilaçet më jetike për shpëtimin e jetës së tyre?! A mendoni ju se ka njerëz që numërojnë kafshatën?! A mendoni ju se e shndërruat këtë komb në kombin e gomoneve?! A mendoni ju se me këto vjedhje e abuzime përzutë nga Shqipëria, nga viti 2014 e deri më sot, 744 mijë shqiptarë dhe nuk guxonin t'i thoni një fjalë të vetme Edi Ramës, përkundrazi, i lëpiheni dhe i serviloseni në mënyrën më të neveritshme, më të paimagjinueshme?! A e dëgjoni se çfarë gjuhe përdor ai?! A mendoni se ne të tjerët nuk i njohim në fjalor ato fjalë, por ne nuk i themi, sepse nuk duam që hapësira informative publike të ndotet siç e ndot ai?!

Ai përpiket të mbulojë abuzimin e tmerrshëm dhe u thotë shqiptarëve se ato flurimet e mia kanë qenë gjysma e një bilete; u thotë shqiptarëve se kam promovuar avionët "Air Albania", në një kohë që kompania ka 3 vjet që nuk dorëzon bilanci dhe është e falimentuar. A ndieni ndonjë përgjegjësi para zgjedhësve shqiptarë, para atyre që ju kanë votuar?! Si ka mundësi që jeni kaq të pandjeshëm?!

Për çfarë të diskutojmë ne këtu, kur kemi të bëjmë me një grup njerëzish, të cilëve vjedhja e pasurive publike të shqiptarëve ua ka verbuar sytë, ua ka mbyllur veshët dhe nuk dëgjojnë asgjë?! Deri kur do të vazhdojë kështu?! 12 nëntori po vjen dhe kjo datë është gjyqi i madh që shqiptarët do t'ju bëjnë ju. Boll u tallët me shqiptarët, boll i shkëlmuat ata duke i vjedhur, boll i përzutë ata nga vatrat e tyre! Mjaft është mjaft. Data 12 është dita e gjyqit popullor ndaj jush. Mblidhi të gjithë Gentian Sharrat dhe veten tënde, por vrimë miu nuk do të gjesh atë ditë, ja këtu po ta them. Dil po deshe në ta mbajt, por ne do të të gjejmë ty, edhe zyrën do ta tregojmë.

Nuk ka parlament si ky. Këtu ka një grup superhajnash dhe një turmë që u mban ison këtyre dhe u bën tualet. Si mund të rrini ju me këta, apo rrini që të përfitonin edhe ju?! Qesh ajo, sepse e merr biftekun 1 mijë, ai tjetri e merr 500 euro dhe kur ulni aty, sigurisht, nuk ju bën përshtypje që bifteku është sa një ka. Ti je e lumtur, por nga i gjete ato para?

Qytetarë,

Këta nuk kanë ndërmend ta bëjnë reformën, por këta mendojnë vetëm si t'ju vjedhin juve. Ne, vërtet që kemi përgatitur një projekt-reformë në respekt tuaj me 97 bashki, por ne kemi thënë që në fillim se këta nuk kanë reformë, këta mendojnë vetëm si të mbajnë karrigen e tyre, derisa t'ua përmbysim karrigen dhe t'i përmbysim me të gjitha.

Qytetarë,

12 nëntori është dita juaj, dita e së vërtetës shqiptare. Ndaj, ju ftoj, kudo që jeni, brenda dhe jashtë Shqipërisë, të bashkohemi për ta përzënë këtë bandë nga pushteti!

Ju faleminderit!